




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.Nr.425/2022
Datë: 3 nëntor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7, paragrafi 1, pika 1.14, të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Labinot Zeka, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, sipas raportit të panelit hetimor Nr.AD/KGJK/10/2022/ GJTHPR-AD/GJTHPR/14/22, të datës 7 korrik 2022 dhe 13 shtator 2022, në pajtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nenin 19 dhe 20, të Rregullores 05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në seancën e mbajtur me 3 nëntor 2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Labinot Zeka, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 5 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar.
2. Për këtë shkelje disiplinore gjyqtarit Labinot Zeka i shqiptohen sanksionet disiplinore vërejtje publike me shkrim dhe zvogëlim i përkohshëm i pagës për 40% për gjashtë (6) muaj.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (më tutje Këshilli), me datë 20 prill 2022, ka pranuar nga Autoriteti Kompetent kërkesë për fillimin e hetimit disiplinor, me pretendim se Labinot Zeka, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, mund të këtë kryer shkelje disiplinore nga neni 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7- në vazhdimësi nuk i kryen detyrat zyrtare me kohë, siç kërkohet me ligj, të përcaktuar me Ligjin Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 5-Profesionalizmi dhe përgjegjësia në punë, të përcaktuar me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtar.

Bazuar në faktet e prezantuara në kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor Autoriteti Kompetent ka konsideruar se në çështjen civile C.nr.3121/20 gjyqtari Labinot Zeka nuk i kishte ndërmarr veprimet konform përgjegjësisë së tija gjyqësore që të sigurohet së lënda do të trajtohet me efikasitet dhe nuk ka ndërmarr veprime që të shmanget zvarritja, dhe si rrjedhojë e mosveprimit të tij konstatohet se ka pasur zvarritje të procedimit të lëndëve C.nr.3121/20, C.nr.1576/15 dhe Cp.nr.09/2021, të kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit. Sipas pretendimit të autoritetit ekziston dyshimi i bazuar se i njëjti me mosveprimet e tija ka kryer shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7 të Ligjit Nr.06/L-

057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokuroreve dhe nenin 5 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë.

Paneli hetimor i themeluar me vendimin e Këshillit të evidentuar KGJK.nr.156/2022, të datës 20 prill 2022, i ka dorëzuar Këshillit raportin me shkrim mbi faktet dhe prova e mbledhura lidhur me hetimin e bërë për shkelje disiplinore të pretenduar të gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Labinot Zeka.

Këshilli për ta shqyrtuar raportin me shkrim të panelit hetimor ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore me 15 korrik 2022, në të cilën kanë prezantuar Kryesuesja e panelit hetimor Ganimete Ibraj Puka dhe avokati i subjektit të hetimit Meriman Vehapi.

Kryesuesi i panelit hetimor (me tutje paneli hetimor), në seancën dëgjimore të Këshillit ka deklaruar se në bazë të pretendimeve të palës ankuese subjekti i hetimit disiplinore nuk ka ndërmarrë veprime procedurale në lëndët C.nr.3121/20, qe ka pas të bëjë me kompensim dëmi në punë dhe ishte kthyer në rigjykim nga gjykata e Apelit në vitin 2020, lëndën C.nr.1576/15 qe ka pas të bëjë me kompensim dëmi nga fatkeqësia në komunikacion, kjo lëndë është e viti 2015, ndërsa paditësit kanë pësuar lëndime të rënda trupore me pasoja për jetë. Në lëndën ishin mbajtur disa seanca nga gjyqtarja S.B, por me transferimin saj në Departamentin Ekonomik, lënda i ishte ndarë gjyqtarit Labinot Zeka, i cili përkundër shkresave për urgjencë nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim edhe pse lënda ishte në fazën përfundimtare. Ndërsa për lëndën Cp.nr.09/2021 ankuesi ka theksuar se me datë 11.01.2021 kreditori ka dorëzuar në gjykatë propozimin për kundër përmbarrim dhe megjithëse kjo natyrë e lëndëve është urgjente, edhe pas kalimit të 1 viti e 2 muaj, gjyqtari nuk ka iniciuar procedurën për lejimin ose jo të këtij përmbarrimi.

Këto pretendime të palës ankuese në bazë të gjeturave nuk ka qenë kontestuese edhe për panelin hetimor, mirëpo paneli ka gjet se subjekti i hetimit ka qenë i ngarkuar edhe me një numër të madh të lëndëve dhe në mungesë të stafit mbështetës.

Avokati Meriman Vehapi si përfaqësues i subjektit të hetimit, në seancën dëgjimore në Këshill deklaroj se nuk ka çfarë të shton sepse raporti i panelit hetimor është përgatitur në mënyrë profesionale.

Këshilli pasi ka dëgjuar deklaratimet e Kryesueses së panelit hetimor dhe avokatit të subjektit të hetimit, me qëllim qe të ketë një pasqyrë dhe gjendje reale faktike për vendosjen sa me të drejtë të rastit, në mënyrë unanime vendosi qe të ja kthej raportin panelit hetimor me vazhdim mandati edhe për dy (2) muaj duke kërkuar qe të plotësohet raporti në lidhje me: numrin e lëndëve me të cilat ka qenë i ngarkuar subjekti i hetimit për periudhën kontestuese, çfarë natyre të lëndëve ka kryer në periudhën kontestuese dhe a ka kryer ndonjë lëndë që lidhet me pagat jubilarë, marrëdhënia e punës si dhe a i ka kryer lëndët sipas rregullave ligjore.

Paneli hetimor, pasi ka përfunduar hetimin sipas kërkesave të Këshillit e ka zhvilluar hetimin dhe me date 19 shtator 2022 i ka dorëzuar Këshillit raportin plotësues me shkrim.

Me datë 22 shtator 2022, Këshilli ka mbajtur seancën dëgjimore të radhës, në ta cilën kanë qenë prezent Kryesuesja e panelit hetimor Ganimete Ibraj Puka dhe av.Meriman Vehapi, si i autorizuar i subjektit të hetimit disiplinor.

Kryesuesja e panelit deklaroj se në bazë të të dhënave të siguruara për periudhën kontestuese 01.01.2021 deri me datë 30.03.2022, subjekti i hetimit ka qenë i ngarkuar me 1472 lëndë, nga këto lëndë 513 kanë

qenë të natyrës përmbartimore, 958 lëndë të çështjeve kontestimore dhe jo kontestimore dhe ne mesin e tyre edhe gjashtë (6) lëndë të kthyera në rigjykim. Ndërsa për periudhën kontestuese 01.01.2022 deri me datë 30.03.2022, subjekti i hetimit ka përfunduar 322 lëndë dhe atë 296 lëndë të çështjeve përmbartimore, prej tyre 93 lëndë janë me pagesë jubilarë 182 lëndë janë borgje, gjobë, kompensim dëmi, si dhe 26 lëndë të çështjeve kontestimore me prioritet, si dhunë në familje, çështjeve familjare, zgjidhje të martesës, besim i fëmijëve, masa të sigurimit të kërkesëpadiisë, ndërsa në muajin janar 2022 deri mars 2022, ka kryer tetë (8) lëndë me pagesë jubilarë, ndërsa nuk ka kryer lëndë që nuk janë me prioritet me përjashtim kur jashtë seancës që ka nxjerr vendim për tërheqje të padiisë për mos pagesë të taksës gjyqësore dhe kur vet pala është tërheq nga padia. Për panelin hetimor ka qenë jo kontestuese se subjekti i hetimit në periudhën kontestuese ka zgjidhur lëndë në çështje përmbartimore, që lidhen me pagat jubilarë-konteste të punës, ndërsa në çështjet kontestimore ka kryer lëndë të natyrës urgjente dhe jo edhe lëndë të kthyera në rigjykim.

Përfaqësuesi i subjektit të hetimit disiplinor deklaroj se mbetet pran deklarimeve të dhënë para panelit hetimor dhe seancës dëgjimore së kaluar në Këshill.

Pas përfundimit të hetimit disiplinor dhe shqyrtimit të shkresave të lëndëve C.nr.3121/20, C.nr.1576/15 dhe Cp.nr.09/2021 për ti vërtetuar faktet në këtë çështje disiplinore Këshilli administroi dhe vlerësoj këto prova: Raporti i panelit hetimor i datës 29.06.2022; kërkesa për fillimin e hetimeve disiplinore e parashtruar nga Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, me datë 13.04.2022; Disa komunikime me emaila; Shkresa e KGJK-së, që i është përcjell çështja Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë; Ankesa e ankuesit e dorëzuar e datës 07.03.2022; Parashtrësia për urgjencë e datës 10.03.2021, për lëndën C.nr.3121/2020, paditës ndaj korporatës Energjetike të Kosovës KEK-DGJE në Prishtinë; Parashtrësia të tjera për urgjencë që janë të njëjta dhe të përsëritura për çështjen në fjalë; Aktvendimin AC.nr.2773/16, të Gjykatës së Apelit, me të cilën është aprovuar ankesa e Korporatës Energjetike të Kosovës dhe është prish aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.390/2009, i datës 27.04.2016; Propozimi për Kundër Përmbartim, i kreditorit ekzekutiv Komuna e Prishtinës kundër debitorit Ilir Fuga nga Prishtina; Parashtrësien e datës 14 shtator 2021, urgjencë për ndërmarrjen e veprimeve; respektivisht dosja 1576/15, në të cilat janë të bashkangjitura padia, urgjencat, komunikimi me email për intervistim; Përgjigjja në hapjen e hetimit disiplinor; Vendimin për ndryshimin e planit vjetor të punës të vitit 2020, i datës 27.12.2019, me të cilin është caktuar gjyqtari Labinot Zeka në Divizionin Civil, në çështjet përmbartimore; shënimi zyrtar i datës 08.09.2020, i nënshkruar nga gjyqtari subjekt i hetimit dhe shefi për menaxhimin e lëndëve Raortin për një familjar të gjyqtari, i sëmur dhe dërgimi për shërim në Turqi, me emrin i lindur në 1957; Njoftimin për hapjen e hetimit disiplinor, datë 29 prill 2022; Procesverbalin e datës 31 maj 2022, i përpiluar nga paneli hetimor; Plani i hetimit; Transkriptin e panelit hetimor të datës 10.06.2022; Autorizimin e avokatit; Procesverbalin e seancës së datës 27.04.2022, në lëndën C.nr.3121/20; Procesverbalin e datës 26.04.2022, në lëndën C.nr.1576/15; Konkluzionin Cp.nr.09/21; Konkluzionin e datës 25.04.2022, në çështjen e njëjtë, Cp.nr.09/21, dhe komunikimin e Kryesueses së panelit me Kryetaren e Gjykatës Themelore në Prishtinë, në procesin e hetimit.

Në fjalën përfundimtare kryesuesja e panelit hetimor theksoi se nuk ka çka të shtoj tjetër përveç të gjeturave të prezantuar në raportet me shkrim.

Ndërsa përfaqësuesi i subjektit të hetimit disiplinor av.Merim Vehapi deklaroj se gjyqtari Labinot Zeka ka qenë i emëruar me vendim si gjyqtar vetëm për lëndët përmbartimore.

Pas vlerësimit të provave të administruara dhe deklaratës së subjektit të hetimit, Këshilli konstatoj që subjekti i hetimit disiplinore nuk kishte ndërmarr veprime e nevojshme për të vendosur për tri (3) lëndët

C.nr.3121/20, C.nr.1576/15 dhe Cp.nr.09/2021 të cilat ishin kthyer në rigjykim nga gjykata e Apelit, edhe përkundër që ishin parashtruar urgjenca nga pala dhe nuk është gjetur asnjë pengës që ka mundur të ndikoj në mos trajtimin e tri lëndëve kontestuese. Me mos trajtimin e lëndëve të kthyera në rigjykim nga gjykata e Apelit subjekti i hetimit nuk ka zbatuar nenin 199 të Ligjit për Procedurën Kontestimore parashihet:” *Gjykata e çështjes ka për detyrë që menjëherë pasi t’i arrij aktvendimi i gjykatës së shkalës së dytë, të caktoj seancën përgatitore apo seancën për shqyrtim kryesor të çështjes e cila duhet të mbahet me se voni brenda afatit tridhjetë (30) ditor pas arritjes së aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, si dhe t’i kryejë të gjitha veprimet procedurale dhe t’i shqyrtoj të gjitha çështjet kontestuese që i ka ofruar gjykata e shkallës së dytë në aktvendimin e sajë”, si dhe edhe Qarkoren e evidentuar si GJS 459/2014, të datës 04.12.2014, të Gjykatës Supreme për trajtim të lëndëve të kthyera në rigjykim, ku është përcaktuar se gjyqtari i ngarkuar më çështjen, ka për obligim ligjor që lëndën që i është rikthyer në rigjykim, ta caktoj menjëherë, në afatin e parë kalendarik që e ka të lirë. Po ashtu në bazë të fakteve dhe provave të gjetura Këshilli ka konstatuar se gjyqtari subjekt i hetimit disiplinor lëndën C.nr.3121/20 e kishte pranuar në zyrë me datë 13.11.2020, fakt të cilin e kishte pohuar edhe vet subjekti i hetimit disiplinor në deklaratën e dhënë të Autoriteti Kompetent dhe përkundër faktit se lënda C.nr.3121/20, që ka qenë lëndë që ka pas të bëjë me kompensim dëmi për shkak të lëndimit në punë, ishte kthyer në rigjykim, nuk kishte ndërmarr asnjë veprim procedural në drejtim të zgjidhjes së saj.*

Gjyqtar i çështjes, ka për detyrim që në afat prej 30 ditëve pas pranimit të lëndës në rigjykim, të ndërmarr të gjitha veprimet procedurale në drejtim të zgjidhjes së saj, sepse lënda ka qenë e natyrës urgjente dhe me prioritet sipas ligjit dhe strategjisë së Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ndërkaq është konstatuar nga Këshilli se lëndën C.nr.3121/20, ka kaluar një periudhë kohore me shume se një (1) vit e katër muaj, dhe i njëjti nuk ka ndërmarrë asnjë veprim procedural.

Për lëndën C.nr.1576/15, në bazë të gjeturave të Këshillit ka rezultuar se subjekti i hetimit lëndën e kishte pranuar nga gjyqtarja S.B, me datë 27.04.2021, dhe nuk kishte mbajtur asnjë seancë gjyqësore për këtë rast, edhe pse lënda ka qenë në procedurë, ku janë mbajtur pesë (5) seanca gjyqësore nga gjyqtarja paraprake dhe konsiderohet si lëndë e vjetër.

Me nenin 411, par.1 dhe 2, të Ligjit për Procedurën Kontestimore përcaktohet: “*seanca për shqyrtim kryesorë të çështjes nuk mund të shtyhet për kohë të pa caktuar*” *Seanca Kryesore dëgjimore nuk mund të shtyhet me shumë se 30 ditë, për veç rasteve të përcaktuara me ligj*”, ndërsa në par.4 të të njëjtit nen parashihet se “*Në çoftë së shtyhet seanca, gjyqtari ka për detyrë që t’i merr të gjithë masat e mundshme me qëllim që të hiqet shkaqet që kanë shkaktuar shtyrjen, si dhe me qëllim që në seancën e ardhshme të përfundoj normalisht shqyrtimi i çështjes*”. Ndërsa sa i përket lëndës Cp.nr.09/21 , është konstatuar se subjekti i hetimit nga data kur e ka pranuar lëndën 01.03.2021, nuk kishte ndërmarr asnjë veprim në drejtim të zgjidhjes së saj deri me datë 25.03.2022, kur kishte marrë konkluzion me të cilën ishte urdhëruar kreditori i kundër përmbarimit të paguaj taksen gjyqësore dhe dorëzimin origjinal apo kopje të noterizuar të aktgjykimit e Gjykatës Supreme, edhe në rastin konkret, lëndët kundër përmbarimit janë të natyrës urgjente sipas Ligjit 04/L-139, për Procedurën Përmbarimore, ku është dashtë të veprohet në afat prej shtatë (7) ditësh.

Gjatë kësaj periudhe subjekti i hetimit edhe përkundër që ka pas obligim ligjor për trajtim të lëndëve të cekura me lartë, i njëjti ka kryer lëndë tjera që nuk kanë qenë me prioritet sipas ligjit.

Nga të gjeturave e Këshillit, të cilat janë kofirmuara edhe nga kryesuesja e panelit hetimor subjekti i hetimit disiplinor gjatë periudhës kontestuese nuk ka mbajtura asnjë seancë për çështje kontestimore dhe nuk ka marrë asnjë vendim meritor, përveç disa lënëve me natyrë dhunë në familje.

Mbi bazën e rrethanave të theksuara me sipër dhe të konstatuara në seancën dëgjimore, Këshilli vlerëson se sjelljet e subjektit të hetimit disiplinor gjyqtari Labinot Zeka janë shkelje të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7, të Ligjit Nr.06/1-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 5, të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar, që ka të bëjë me profesionalizmin dhe përgjegjësinë në punë.

Këshilli i shqyrtoj me kujdes masat disiplinore të parapara me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe vlerësoj se në rastin e gjyqtarit Labinot Zeka sanksioni *vërejtje publike me shkrim dhe zvogëlim i përkozhëm i pagës për 40% për gjashtë (6) muaj*, është masë proporcionale në raport në shkeljen e bërë të gjyqtarit dhe se e njëjta do të shërbej si mase për disiplinimin e gjyqtarit dhe si preventive për të ardhmen.

Nga sa u tha me lartë, konform nenit 7, paragrafi 1, pika 1.2, 1.3 dhe paragrafi 2, pika 2.1, 2.2, dhe 2.5, të Ligjit Nr.06/1-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.Nr.425/2022, datë: 3 nëntor 2022

Albert ZOGAJ
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 15 ditëve, pas pranimin të vendimit.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- *Albina Shabani Rama, Kryetare, Gjykata Themelore në Prishtinë;*
- *Labinot Zeka, Gjyqtar, Gjykata Themelore në Prishtinë;*